c. Dokumentacioni shtesë për leje unike si i transferuar brenda ndërmarrjes (TBN):

i. Deklaratë e transferimit brenda ndërmarrjes;

ii. Dokument (kontratë pune) ndërmjet punonjësit dhe ndërmarrjes dërguese, në të cilën specifikohen pozicioni i punës, aktivitetet që do të kryhen dhe elementet e tjera të kontratës së punës, sipas legjislacionit shqiptar.

ç. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëtor ndërkufitar:

iii. Kontrata e punës e lidhur me punëdhënësin nëse është me statusin e punëmarrësit ose dokumentacion për statusin e tij si punëdhënës/i vetëpunësuar;

iv. Dokumentacioni që vërteton se punëdhënësi e ka punësuar në kuadër të një marrëveshjeje (nëse ka);

v. Dokumentacioni që i huaji provon se ka vendbanim në një zonë gjeografike kufitare të territorit të Republikës së Shqipërisë.

d. Dokumentacioni shtesë për leje unike për formim profesional:

i. Vërtetimi i regjistrimit në kursin e formimit profesional, lëshuar nga subjekti, ofrues i formimit;

ii. Dokumenti për llogarinë bankare, në vlerën e pagës minimale mujore, për kohën e kryerjes së kursit (për të vërtetuar mundësinë e përballimit të jetesës).

dh. Dokumentacioni shtesë për leje unike për sportistë:

vi. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e personit juridik ose ekstrakti i regjistrimit në QKB për punëdhënësin/klubin sportiv, ku ai do të punësohet;

vii. Kontrata e punës e lidhur me punëdhënësin në përputhje me profesionin e tij si sportist.

e. Dokumentacioni shtesë për leje unike për shërbime vullnetare:

viii. Marrëveshja me organizatën jofitimprurëse, që ofron shërbime bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë për të huajt, që do të shërbejnë vullnetarisht;

ix. Burimet e disponueshme për të mbuluar kostot e jetesës, strehimit dhe një shumë minimale/"para xhepi" përgjatë qëndrimit, sipas standardit të minimumit jetik;

x. Kontrata e vullnetarizmit.

ë. Dokumentacioni shtesë për leje unike për punonjës me kualifikim të lartë:

xi. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

xii. Kontrata e vlefshme pune me një punëdhënës, për punësim me kualifikim të lartë, në përputhje me formimin e tij profesional, me kohëzgjatje së paku 1-vjeçare në Republikën e Shqipërisë, ku disponon dëshminë e kualifikimit të lartë profesional mbi nivelin e 4 (katërt) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

xiii. Dokumenti që vërteton kualifikimet e larta profesionale përkatëse në profesionin/pozicionin e punës apo sektorin e specifikuar në kontratën e punës për profesionet e parregulluara.

f. Dokumentacioni i veçantë për leje unike për shërbime kontraktuese:

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

ii. Miratimi për punësim për shërbime kontraktuese.

g. Dokumentacioni shtesë për leje unike për të vetëpunësuar:

i. Dokumentacioni përkatës për qëndrimin si i vetëpunësuar;

ii. Vlerësimi nga komisioni përkatës për të vetëpunësuarit;

iii. Komisioni vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si të vetëpunësuar shqyrton dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projektide për biznesin/aktivitetin (që pasqyron minimalisht elementet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive);

- Dokument që provon se ka mjete të mjaftueshme financiare, jo më pak se 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose vlera ekuivalente me të në dollarë ose euro (vërtetim nga banka në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e origjinës);

- Dokument që provon aftësitë e nevojshme (certifikatë/diplomë ose dokument të barasvlefshëm me të), ose licencë për ushtrimin e profesionit (sipas legjislacionit për profesionet e rregulluara);

- Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

gj) Dokumentacioni shtesë për leje unike për punonjës lëvizës digjital:

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

ii. *vetëdeklarim mbi një kontratë të vlefshme* punësimi me punëdhënësin jashtë shtetit apo kontratë shërbimi me kontraktuesin ose porositësin jashtë shtetit, që provon se do të punojë pa një seli konkrete për punë specifike, të cilat lejojnë punën me mjete të teknologjisë së informacionit;

iii. vetëdeklarim mbi disponimin e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, në vlerë jo më pak se 408 000 (katërqind e tetë mijë) lekë, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iv. Policë të sigurimit shëndetësor, të vlefshme për të paktën 1 (një) vit;

v. vetëdeklarim mbi ekzistencën e dokumenteve që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

h) Dokumentacioni shtesë për leje unike për investitorë:

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm si investitor;

ii. Vlerësimi nga komisioni përkatës për investitorët.

i. Dokumentacioni shtesë për leje unike për kategori të veçanta:

i. Dokumentacioni përkatës për lejen e qëndrimit;

ii. Kontrata e vlefshme e punës/kontratë shërbimi/marrëveshje.

j. Dokumentacioni i lejeve të qëndrimit për motive të tjera:

a) për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit:

i. Dokumentacioni përkatës për lejen e qëndrimit;

ii. Kontrata e vlefshme e punës/kontratë shërbimi/marrëveshje.

b) për leje qëndrimi për përdorim të pasurisë së paluajtshme:

i. Certifikata e pronësisë së banesës (fotokopje e noterizuar e kontratës së shitblerjes);

ii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, sipas motivit të qëndrimit, për periudhën e kërkuar të qëndrimit;

iii. Deklarata individuale mbi motivin e qëndrimit në Shqipëri.

c) për leje qëndrimit për pensionistët:

i. Vërtetim pensioni;

ii. Vërtetim i të ardhurave vjetore deri në vlerën 1 200 000 lekë nga pensioni në shtetin e origjinës.

DH. Dokumentacioni për ripërtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit e tipit "B"

i. I huaji për përtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit duhet të plotësojë kërkesat e legjislacionit për të huajt dhe dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje të përkohshme qëndrimi,

ii. I huaji duhet të paraqesë, gjithashtu, dëshminë e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe ato të taksave lokale për vitin e fundit kalendarik, sipas specifikave të motivit të lejes së qëndrimit.

E. Dokumentacioni për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit të tipit "C"

Për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit, i huaji duhet të plotësojë kërkesat e nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", dhe përveç plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me leje të përkohshme qëndrimi, në varësi të motivit, duhet të dorëzojë edhe vërtetim të gjendjes gjyqësore të marrë në Shqipëri, të lëshuar në 6-mujorin e fundit, si dhe të vërtetojë siguracionin shëndetësor.

Për personat, që kanë përfituar statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin, duhet të dorëzojnë vendimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, për dhënien e këtij statusi.

Ë. Dokumentacioni për lëshimin e lejes së qëndrimit për raste të veçanta të tipit "C"

1. Kriteret dhe procedura për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit të tipit "C" janë ato të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi.

2. I huaji pajiset me leje të përhershme qëndrimi në raste të veçanta, në përmbushje të kushteve të parashikuara në ligjin për të huajt, nëse:

a) ai paraqet dokumentacionin bazë dhe certifikatën që vërteton lidhjet familjare me shtetasin shqiptar apo certifikatën që vërteton vendin e lindjes, si dhe kopje të lejes së përhershme të qëndrimit të prindërve;

b) i huaji investues paraqet vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike se ka marrë statusin investitor strategjik. Për familjarët duhet dorëzuar certifikata familjare, ndërsa për personelin kyç duhet dorëzuar kopje e kontratës së punës pa afat, që lidhet me këtë investim.

Shfuqizuar pika 3.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Procedura e aplikimit për lejet e qëndrimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë do të vijojë të kryhet në bazë të parashikimeve të vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik për të huajt nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, parashikuar në kreun III, seksioni D sipas këtij vendimi. Dispozitat e tjera të vendimit të sipërpërmendur shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik për të huajt, sipas këtij vendimi, *brenda datës 1 shtator 2022.*

2/1. Parashikimet e shënjuara me (*) në formularin e aplikimit për leje unike do të hyjnë në fuqi pas datës 1 shtator 2022.

2/2. Aplikimi për regjistrimin e adresës do të mundësohet edhe on-line pas datës 1 shtator 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS NR. 1

Shtetet, shtetasit e të cilave bëjnë përjashtim nga detyrimi i regjistrimit pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku kanë vendosur vendbanimin.

Nr.	Shteti
1	Australi
2	Andorra
3	BE/zona Shengen
4	Mbretëria e Bashkuar
5	Irlanda e Veriut
6	Izrael
7	Japoni
8	Kanada
9	Lihtenshtejn
10	San Marino
11	Selia e Shenjtë
12	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
13	Zelandë e Re
14	Kosovë
15	Maqedoni e Veriut
16	Serbi
17	Mal i Zi
18	Bosnje dhe Hercegovina

ANEKS NR. 2

Listave e shteteve, shtetasit e huaj mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit që hyjnë pa vizë në Shqipëri

	Lista e shteteve që hyjnë në Shqipëri pa vizë, duke përdorur pasaportë diplomatike ose shërbimi	**Diplomatike**	**Shërbimi**	**Speciale**
1	Afrika e Jugut	x	x	
2	Algjeri	x	x	
3	Arabia Saudite	x		x
4	Egjipt	x	x	
5	Ekuador	x	x	
6	Indi	x	x	
7	Indonezi	x	x	
8	Jordani	x	x	
9	Katar	x		x
10	Kuba	x	x	
11	Marok	x	x	
12	Mongoli	x	x	
13	Oman	x	x	x
14	Rusi	x	x	
15	Tajlandë	x	x	
16	Tunizi	x		

17	Vietnam	x	x	

ANEKS NR. 3

(ndryshuar pika 3 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021; ndryshuar pika 3 me VKM nr. 251, datë 20.4.2023; VKM nr. 134, datë 06.03.2024; ndryshuar pika 3 me VKM nr. 168, datë 20.3.2024)

1. Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe dokumenti që duhet të paraqesin

Nr.	**Shteti**	**Me pasaportë**	**Me kartë identiteti**
1	Andorra	x	
2	Argjentinë	x	
3	Armeni*	x	
4	Australi	x	x
5	Austri	x	x
6	Azerbajxhan*	x	
7	Belgjikë	x	x
8	Bjellorusi	x	
9	Bosnjë dhe Hercegovinë	x	x
10	Brazil	x	
11	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	x	x
12	Bullgari	x	x
13	Danimarkë	x	x
14	Estoni	x	x
15	Finlandë	x	x
16	Francë	x	x
17	Gjermani	x	x
18	Greqi	x	x
19	Holandë	x	x
20	Hong Kong, Kinë*	x	x
21	Hungari	x	x
22	Irlandë	x	x
23	Islandë	x	x
24	Itali	x	x
25	Izraeli	x	
26	Japoni	x	
27	Kanada	x	x
28	Kazakistan*	x	x
29	Kili	x	
30	Kosovë	x	x
31	Kroaci	x	x
32	Kuvajt*	x	
33	Letoni	x	x
34	Lihtenshtejn	x	x
35	Lituani	x	x

36	Luksemburg	x	x
37	Malajzi	x	
38	Mali i Zi	x	x
39	Maltë	x	x
40	Maqedoni e Veriut	x	x
41	Monako	x	x
42	Norvegji	x	x
43	Poloni	x	x
44	Portugali	x	x
45	Qipro	x	x
46	Rep. e Koresë (së Jugut)	x	x
47	Republika Çeke	x	x
48	Republika Popullore e Kinës*	x	
49	Rumani	x	x
50	San Marino	x	x
51	Selia e Shenjtë	x	x
52	Serbia	x	x
53	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	x	x
54	Singapor	x	x
55	Sllovaki	x	x
56	Slloveni	x	x
57	Spanjë	x	x
58	Suedi	x	x
59	Tajvan, Kinë*	x	
60	Turqi*	x	
61	Ukrainë*	x	
62	Zelandë e Re	x	x
63	Zvicër	x	x

2. Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë, si rrjedhojë e hyrjes pa vizë në zonën Shengen

1	Antigua dhe Barbuda*	x
2	Bahamas*	x
3	Barbado*	x
4	Brunei*	x
5	Guatemalë*	x
6	Gjeorgji*	x
7	Honduras*	x
8	Kolumbi*	x
9	Kosta Rika*	x
10	Macao, Kinë*	x
10	Mauritius*	x
12	Meksikë*	x
13	Moldavi*	x

14	Nikaragua*	x
15	Panama*	x
16	Paraguai*	x
17	Peru*	x
18	Salvador*	x
19	Seychelles*	x
20	St. Kitts and Nevis*	x
21	Trinidad dhe Tabako*	x
22	Uruguai*	x
23	Venezuelë*	x

* Shtetasit e shteteve të shënuara me simbolin (*), për të qëndruar më shumë se 90 ditë në 180 ditë duhet të pajisen me vizë të tipit "D", me qëllim aplikimin për leje qëndrimi.

3. Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë për motive turistike në Republikën e Shqipërisë dhe me dokumentin pasaportë për një periudhë të kufizuar/për periudhën nga data 1 prill deri më 31 dhjetor 2024.

Nr.	***Shteti***
1	*Indonezia.*

ANEKS NR. 4

Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë

(Ndryshuar me Vendimin nr. 329, datë 2.5.2024)

	SHTETET QË HYJNË ME VIZË		**VIZA "C"/ "A"**			**VIZA "D"**
Nr.	**Shteti**	**Përfaqësia ku mund të aplikohet**	**Kosto 1-hyrje**	**Kosto 2-hyrje**	**Kosto shumë hyrje**	**Kosto**
1	Afganistan	Ankara, Stamboll	4566.60	4566.60	4566.60	4566.60
2	Afrika e Jugut	Romë, Londër	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
3	Algjeria	Paris	gratis	gratis	gratis	gratis
4	Angola	Romë	5074.00	7611.00	10148.00	10148.00
5	Antigua dhe Barbuda	Londër				3551.80
6	Arabi Saudite	Riad	5479.92	5479.92	5479.92	5479.92
7	Armenia	Ankara, Moskë				4059.20
8	Azerbajxhan	Ankara, Moskë				4059.20
9	Bahamas	Londër				3551.80
10	Bahrein	Riad, Doha	6088.80	6088.80	6088.80	6088.80
11	Bangladesh	Pekin	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
12	Barbados	Londër				2537.00
13	Belize	Londër	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
14	Benin	Paris	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
15	Bjellorusi	Moskë, Varshavë				10148.00
16	Bolivi	Brazilia	3044.40	3044.40	5074.00	5074.00
17	Botsvanë	Paris	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
18	Bregu i Fildishtë	Londër	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
19	Brunei	Romë, Riad				2537.00
20	Burkina Faso	Romë	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
21	Egjipt	Kajro	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
22	Ekuador	Brazilia	1014.80	1014.80	1014.80	1014.80
23	Emiratet e Bashkuara Arabe	Abu Dhabi				2537.00
24	Eritre	Kajro	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
25	Etiopi	Kajro	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
26	Filipine	Pekin	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
27	Gabon	Kajro, Romë	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40

28	Gana	Kajro, Romë	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
29	Guajanë	Brazilia, Romë				3044.40
30	Guatemalë	Brazilia				2537.00
31	Guineja	Kajro, Stamboll	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
32	Gjeorgji	Ankara, Stamboll				4059.20
33	Haiti	Brazilia, Nju-Jork	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
34	Honduras	Brazilia, Nju-Jork				3044.40
35	Hong Kong, Kinë	Pekin				3551.80
36	Indi	Pekin, Abu Dhabi, Stamboll	1522.20	1522.20	1522.20	1522.20
37	Indonezi	Pekin	3348.84	3348.84	3348.84	3348.84
38	Irak	Ankara, Stamboll	7205.08	7205.08	7205.08	7205.08
39	Iran	Ankara, Stamboll	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
40	Ishujt Fixhi	Londër, Tokio	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
41	Jemen	Riad, Abu Dhabi	2029.60	7103.60	7103.60	7103.60
42	Jordani	Kajro	2334.04	2334.04	2334.04	2334.04
43	Kamboxhia	Pekin	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
44	Kamerun	Kajro	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
45	Katar	Doha	2029.60	4059.20	4059.20	4059.20
46	Kazakistan	Ankara, Moskë				10148.00
47	Kenia	Kajro	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
48	Republika Popullore e Kinës	Pekin				Gratis
49	Kirgistan	Ankara, Moskë	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
50	Kolumbi	Brazilia				4566.60
51	Kongo	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
52	Kore, Republika Popullore	Pekin, Sofje	1014.80	1014.80	1014.80	1014.80
53	Kosta Rika	Brazilia				3044.40
54	Kubë	Brazilia, Sofje	3044.40	3044.40	6596.20	6596.20
55	Kuvajt	Kuvajt				2537.00
56	Lesoto	Kajro, Stamboll	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
57	Libani	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	5074.00	5074.00
58	Liberi	Bukuresht	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
59	Libi	Kajro, Stamboll	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
60	Madagaskar	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
61	Makao,Kinë	Pekin				3551.80
62	Malavi	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
63	Maldives	Londër	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
64	Mali	Romë	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
65	Marok	Bukuresht, Paris	1116.28	1116.28	1116.28	1116.28
66	Mauritani	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
67	Mauritius	Londër				2537.00
68	Meksikë	Romë				3044.40
69	Moldavi	Bukuresht, Sofje, Ankara, Stamboll				10148.00
70	Mongoli	Moskë, Pekin	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
71	Mozambik	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
72	Namibi	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
73	Nepal	Pekin	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
74	Nigeri	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
75	Nikaragua	Romë				3044.40
76	Oman	Riad, Abu Dhabi	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
77	Pakistan	Kajro, Stamboll	2029.60	3551.80	3551.80	3551.80
78	Palestinë	Ankara, Kajro, Stamboll				
79	Panama	Romë				10148.00
80	Paraguai	Brazilia				5074.00
81	Peru	Brazilia, Madrid				6088.80
82	Republika Domenikane	Brazilia, Nju-Jork	4059.20	5074.00	7103.60	7103.60
83	Ruanda	Kajro, Stamboll	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80

84	Rusi	Moskë	3044.40	5074.00	5074.00	5074.00
85	Salvador	Londër				2029.60
86	Sao Tome dhePrincipe	Londër	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
87	Senegal	Kajro, Stamboll, Paris	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
88	Seychelles	Kajro				3551.80
89	Sierra Leone	Kajro, Stamboll	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
90	Siri	Kajro, Stamboll	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
91	Somali	Kajro, Riad	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
92	Sri Lanka	Pekin	608.88	1014.80	1014.80	1014.80
93	Sudan	Kajro	6291.76	6291.76	6291.76	6291.76
94	Suriname	Brazilia	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
95	St. Kitts and Nevis	Tokio, Londër				3551.80
96	Tailandë	Pekin	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
97	Tanzani	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
98	Taxhikistan	Ankara, Moskë	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
99	Togo	Kajro, Stamboll	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
100	Trinidad dhe Tabako	Londër				2029.60
101	Tunizi	Kajro, Stamboll	1116.28	1116.28	1116.28	1116.28
102	Turkmenistan	Ankara, Stamboll, Moskë	3044.40	5074.00	6088.80	6088.80
103	Turqi	Ankara, Stamboll				3551.80
104	Ugandë	Kajro, Stamboll	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
105	Ukrainë	Varshavë, Shkup	8 600	8600	8600	8600
106	Uruguai	Brazilia, Romë				3044.40
107	Uzbekistan	Stamboll, Moskë	3044.40	5074.00	10148.00	10148.00
108	Venezuelë	Brazilia, Romë				3044.40
109	Vietnam	Pekin	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
110	Xhamajkë	Londër, Nju-Jork	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
111	Zambia	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
112	Zimbabve	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
113	Të tjera	Në Amb. RSH më të afërt	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.

ANEKSI NR. 5
Formularin e aplikimit për vizë,

Formulari i aplikimit për vizë Shqiptare
Application for Albanian Visa

Ky formular është pa pagesë
This application form is free

<table>
<tr><td colspan="2">1. Surname(s) (family name(s))/ Mbiemri (at)</td><td rowspan="2">Vetëm për Konsullin

Data e aplikimit:</td></tr>
<tr><td colspan="2">2. Surname(s) at birth (earlier family name(s))/ Mbiemri i lindjes (mbiemra më të hershëm)</td></tr>
<tr><td colspan="2">3. First names (given names)/ Emri (at)</td><td rowspan="2">Emri i Konsullit që pranon aplikimin:</td></tr>
<tr><td>4. Date of birth (year-month-day)/ Datëlindja (viti-muaji-dita)</td><td>5. ID-number (optional)/ Numri i identifikimit (jo i detyrueshëm)</td></tr>
<tr><td colspan="2">6. Place and country of birth/ Rrethi dhe vendi i lindjes</td><td rowspan="3">Dokumentat mbështetës:
1.Vlefshmëria e pasap. 2.Mjete Financiare
3.Transporti
4.Sigurimi Shendetsor
Të tjera</td></tr>
<tr><td>7. Current nationality/ies/ <u>Shtetësi(të) aktuale</u></td><td>8. Original nationality (nationality at birth)/ Shtetësia origjinale (Shtetësia e lindjes)</td></tr>
<tr><td>9. Sex <u>Gjinia (Mashkullore / Femërore)</u>
□ Male □ Female</td><td>10. Marital status : Gjëndja Civile
Single/ beqar(e) □ Married/ i(e) martuar □
Separated / i(e) ndarë □
Divorced/ i(e) divorcuar
Ëidoë(er) / i(e) ve □ Other/ tjetër</td></tr>
<tr><td>11. Father’s name/ Emri i babait</td><td>12. Mother’s name/ Emri i nënës</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2"></td><td>Viza</td></tr>
<tr><td colspan="2">13. Type of passport:/ Tipi i Pasaportës
National passport/ Pasaportë kombëtare □ Diplomatic passport/ Pasaportë diplomatike □ Service passport/ Pasaportë shërbimi □ Travel document (1951 Convention) / Dokument udhëtimi (Konventa e vitit1951)
Alien’s passport/ Pasaportë e huaj □ Seaman’s passport/</td><td>Refuzuar
Aprovuar

Tipi i vizës
A
B</td></tr>
</table>

Pasaportë marinari □ Other travel document (please specify): / Dokument tjetër udhëtimi (lutemi specifikoni): ……..…		
14. Number of passport/ Numri i Pasaportës	**15. Issued by/ Lëshuar nga**	C D/
16. Date of issue / Data e lëshimit	**17. Valid until/ E vlefshme deri më**	**Numri i hyrjeve** një dy shumë
18. If you reside in a country other than your country of origin, have you permission to return to that country? Në rast se qëndroni në një vend tjetër nga ai i origjinës, a keni lejë kthimi në atë vend? □ No / Jo □ Yes, (number and validity) / Po, (numri dhe vlefshmëria)……		
*** 19. Current occupation/ Punësimi aktual**		Kohqëndrimi_____
*** 20. Employer and employer's address and telephone number. For students, name and address of school. /. Punëdhënësi, adresa e punëdhënësit dhe numri i telefonit. Për studentët, emri dhe adresa e shkollës.**		E vlefshme nga___ _____ Deri më___

21. Main destination / Destinacioni kryesor	**22. Type of Visa /Tipi i Vizës :** Airport transit / Transit në aeroport Transit / Transit Short stay / Qëndrim i shkurtër Long stay / Qëndrim i gjatë	**23. Visa / Viza** □ Individual / Individuale
24. Number of entries requested / Numri i hyrjeve të kërkuara: Single entry / Një hyrje □ Tëo entries / Dy hyrje Multiple entries / Shumë hyrje		**25. Duration of stay / Kohëzgjatja e qëndrimit:** Visa is requested for:____days / Viza kërkohet për: …….ditë

26. Other visas (issued during the past three years) and their period of validity/ Viza të tjera (të lëshuara gjatë tre viteve të fundit) dhe periudha e vlefshmërisë së tyre
27. In the case of transit, have you an entry permit for the final country of destination? / Në rast transiti, a keni leje hyrje për vendin e destinacionit përfundimtar? □ No / Jo □ Yes , valid until: / po , e vlefshme deri më: Issuing authority: / Autoriteti lëshues:
28. Previous stays in Albania / Qëndrime të mëparshme në Shqipëri

29. Purpose of travel / Qëllimi i udhëtimit Tourism / Turizëm □ Business / Biznes □ Visit to Family or Friends/ Vizitë Familjes ose Miqve □ Cultural/Sports / Kulturore/Sportive □ Official / Zyrtare □ Medical reasons / Arsye mjekësore Other (please specify): Tjetër (lutemi specifikoni): ……..

*** 30. Date of arrival / Data e mbërritjes**	**31. Date of departure / Data e nisjes**
*** 32. Border of first entry or transit route / Kufiri i hyrjes së parë ose rruga transit**	**33. Means of transport / Mjeti i transportit**

*** 34. Name of host or company in Albania and contact person in host company.** **If not applicable, give name of hotel or temporary address in Albania .Emri i pritësit ose i kompanisë/ institucionit në Shqipëri dhe personi i kontaktit në kompaninë/institucionin pritëse. Përndryshe, jepni emrin e hotelit ose adresën e përkohshme.**	
Name / Emri	**Telephone and telefax / / Telefoni dhe Faksi**
Full address/ / Adresa e plotë	**E-mail address / / E-mail**

*** 35. Ëho is paying for your cost of travelling and for your costs of living during your stay? / Kush paguan për shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës gjatë qëndrimit tuaj?** □ Myself / Vetë □ Host person/s / Person-i(at) mikpritës □ Host company

(State ëho and hoë and present corresponding documentation): / Kompania mikpritëse. (Specifikoni kush dhe si dhe paraqisni dokumentacionin përkatës): …… ……..……
*** 36. Means of support during your stay / Mjetet e përballimit të shpenzimeve gjatë qëndrimit tuaj** Cash / Të holla □ Travellers' cheques / Çeqe udhëtarësh □ Credit cards / Karta Krediti □ Accommodation / Strehim □ Other: / Tjetër Travel and/or health insurance. Valid until: / Sigurime shëndetësore dhe/ose udhëtimi. Të vlefshme deri më: …… …..……..

37. Spouse's family name / Mbiemri i bashkëshort-it (es)		**38. Spouse's family name at birth / Mbiemri i bashkëshort-it(es) në lindje**
39. Spouse's first name / Emri i bashkëshort-it(es)	**40. Spouse's date of birth / Datëlindja e bashkëshort-it(es)**	**41. Spouse's place of birth / Vendlindja e bashkëshort-it(es)**
42. Children / Fëmijët / (Applications must be submitted separately for each passport / Aplikimet duhet të dorëzohen më vete për secilën pasaportë) **Surname / Mbiemri First name / EmriDate of birth / Datëlindja** 1 2 3		

43. Personal data of the Albanian citizen or resident you depend on. This question should be ansëered *only* by family members of Albanian citizens or resident. / **Të dhënat personale të shtetasit shqiptar ose të huajit rezident në Shqipëri nga i cili vareni. Kësaj pyetje duhet t'i përgjigjen vetëm pjesëtarët e familjeve të shtetasve shqiptar ose të huajve rezident në Shqipëri.**		
Name / Mbiemri		**First Name / Emri**
Date of Birth / Datëlindja	**Nationality / Kombësia**	**Number of passport / Numri i Pasaportës**
Family relationship of an Albanian citizen or resident: / Lidhja familjareme shtetasin shqiptar ose rezidentit në Shqipëri		

[1] Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021:
Fushat në pikën 37 deri në pikën 42 të formularit plotësohen nga të huajt të cilët kërkojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim bashkimin familjar.

44. I am aëare of and consent to the folloëing: any personal data concerning me ëhich appear on this visa application form ëill be supplied to the relevant authorities in Albania and processed by those authorities, if necessary, for the purposes of a decision on my visa application. Such data may be input into, and stored in, databases accessible to the relevant authorities in Albania.
At my express request, the consular authority processing my application ëill inform me of the manner in ëhich I may exercise my right to check the personal data concerning me and have them altered or deleted, in particular, should they be inaccurate, in accordance ëith the national laë of the state concerned.
I declare that to the best of my knoëledge all particulars supplied by me are correct and complete.
I am aëare that any false statements ëill lead to my application being rejected or to the annulment of a visa already granted. I undertake to leave the territory of Albania upon the expiry of the visa, if granted.
I have been informed that possession of a visa is only one of the prerequisites for entry into Albania. The prerequisites for entry ëill be checked again on entry into Albanian territory.

Unë jam në dijeni dhe jap pëlqimin për sa më poshtë: çdo e dhënë personale që ka të bëjë me mua në këtë formular aplikimi për vizë do t'i jepet organeve përkatëse në Shqipëri dhe nëse është e nevojshme do të përpunohen nga këto autoritete për të marrë një vendim mbi aplikimin tim për vizë. Të dhëna të tilla mund regjistrohen dhe ruhen në sisteme të dhënash, të përdorshme edhe nga organet përkatëse shqipatre. Sipas kërkesës time të shprehur, organi konsullor që përpunon aplikimin tim do të më njoftojë mua mbi mënyrën sipas së cilës mund të ushtroj të drejtën time për të kontrolluar të dhënat e mia personale dhe t'i ndryshoj ose fshij, sidomos, nëse ato nuk janë të sakta, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Unë deklaroj që, sipas njohurive të mia më të mira, të gjitha detajet e dhëna nga unë janë të sakta dhe të plota. Jam në dijeni se çdo deklaratë e rremë do të çojë në refuzimin e aplikimit tim ose anullimin e një vize të lëshuar. Unë marr përsipër të largohem nga territori shqiptar me skadimin e vizës, nëse më jepet.
Jam i informuar se zotërimi i vizës është vetëm një nga kushtet paraprake të hyrjes në territorin shqipatar. Kushtet paraprake për hyrje, do të kontrollohen përsëri tek hyrja në territorin shqiptar.

45. Applicant's home address / Adresa e shtëpisë së aplikantit	**46. Telephone number/ Numri i telefonit**	**47. E-mail address / E-mail**
48. Place and date / Vendi dhe data	**49. Signature (for minors, signature of custodian/guardian)/ Nënshkrimi (për minorenët, firma e kujdestarit)**	

[1] Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021:
Pas pikës 49 shtohet shënimi:
"Ky formular nuk do të aplikohet pas datës 1 shtator 2022 për të huajt që aplikojnë për leje unike.".

Aneksi nr. 6

Vlera e tarifave të shërbimit dhe pajisjes me leje qëndrimi dhe leje unike për të huajt[1].						
Nr.		Tarifa e lejes më shumë se 90 ditë deri në 1 vit, për herë të parë[2].	Tarifa e lejes deri në 2 vjet, për herë të parë.	Tarifa e lejes deri në 3 vjet, për herë të parë.	Tarifa për ripërtëritjen e lejes.	Tarifa e lejes së përhershme të qëndrimit.
1.	**Për motive të bashkimit familjar**	4 500 (mijë lek)	-	-	2 250	12 500
2.	**Për motive studimi (student dhe nxënës)**	4 500	-	-	2 250	-
3.	**Për të trajnuarin pa pagesë**	4 500	-	-	2 250	-
4.	**Për au pairs**	4 500	-	-	2 250	-
5.	**Për shkëmbime rinore**	4 500	-	-	2 250	-
6.	**Për kërkim shkencor**	4 500	-	-	-	-
7.	**Për kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët**	4 500	-	-	-	-
8.	**Për raste humanitare**	Pa tarifë	-	-	Pa tarifë	-
9.	**Për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore**	Pa tarifë	-	-	Pa tarifë	-
10.	**Për personat pa shtetësi**	4 500	-	-	2 250	12 500
11.	**Leje unike si punëmarrës**	8 000	9 000	10 000	4 000	12 500
12.	**Leje unike për punësim stinor**	4 500	-	-	-	-
13.	**Leje unike për të transferuar brenda ndërmarrjes**	8 000	-	-	4 000	-
14.	**Leje unike si punëtor ndërkufitar**	4 500	-	-	2 250	-
15.	**Leje unike për formim profesional**	8 000	9 000	-	4 000	-
16.	**Leje unike për sportistë**	8 000	-	-	4 000	12 500
17.	**Leje unike për shërbim vullnetar**	4 500	-	-	2 250	-

[1] Këto tarifa nuk përfshijnë kostot e vlerës së kartës biometrike.

[1] *Ndryshuar aneksi 6 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.4.2022*

18.	**Leje unike për punonjës me kualifikim të lartë**	-	9 000	-	4 500	12 500
19.	**Leje unike për persona të vetëpunësuar**	8 000	9 000	10 000	4 000	12 500
20.	**Leje unike për punonjës lëvizës digjital**	4 500	-	-	2 250	12 500
21.	**Leje unike për investitorë**	-	9 000	-	4 500	12 500
22.	**Leje unike për shërbime kontraktuese**	8 000	-	-	4 000	-
23.	**Leje unike për kategori të veçanta**	8 000	-	-	4 000	12 500
24.	**Për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit**	8 000	-	-	4 000	12 500
25.	**Për leje qëndrimi për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi**	8 000	-	-	4 000	12 500
26.	**Për leje qëndrimi për pensionistë**	4 500	-	-	2 250	12 500
27.	Vlera e tarifës për kategoritë që pajisen me leje qëndrimi 5-vjeçare, për herë të parë, është 12 000 mijë lek.					

Aneksi nr. 7

Formati i lejes provizore të qëndrimit dhe lejes për motive humanitare të qëndrimit të tipit "A"

_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin_____

LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT

RESIDENCE PERMIT OF THE FOREIGNER

TIPI _____

Type

Foto

Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____

Firs name (s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA dd.mm.yy

Place of birth *Date of birth*

NUMRI IDENTITETIT PËR TË HUAJ (FID) _____

Foreigner Identity Number FID

NUMRI I PASAPORTËS/DOKUMENT IDENTIFIKIMI _____

Passport Number/ Identification document

SHTETËSIA _____ GJINIA _____

1

[1] *Ndryshuar aneksi 7 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.4.2022*

Nationality *Sex*

MOTIVI I QËNDRIMIT _____

Purpose of Stay

ADRESA NË SHQIPËRI _____

Address in Albania

Kjo leje qëndrimi është e vlefshme nga data dd.mm.yy deri më dd.mm.yy

This Residence Permit is valid from until

DREJTOR

Director

_____

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit

ANEKSI NR.8
Formulari standard i aplikimit të lejes unike

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME

LEJE UNIKE
UNIC PERMIT

APLIKIM PER LEJE UNIKE / UNIC PERMIT APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për leje unike në Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes formularin e aplikimit. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Lexoni udhëzimet për plotësimin e formularit në www.asp.gov.al → English→Application forms. Sqarimet që ju duhet të bashkëlidhni në aplikimin tuaj janë të shënuara në seksionin E të këtij formulari.

This form is for applying for a Albanian unic permit. Carefully fill in the application form. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Read the instructions for filling in the form at www.asp.gov.al → English →Application forms. Clarifications that you need to append to your application are listed in Section E of this form.

Aplikim për / Application for ☐ LEJE UNIKE për herë të parë / A first unic permit ☐ Rinovim LEJE UNIKE / Renewed unic permit

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:
and hereby submit the following information for the processing of my application:

SEKSIONI A / SECTION A

1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant

1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit
Information on Passport or travel document

☐ Numri i Pasaportës: / Passport no.	
☐ Numri i Pasaportës Shërbimi /Official passport no.	
☐ Numri i Dokumentit të udhëtimit të refugjatit / Refugee's travel document no.	
☐ Numri i Pasaportës për të huajt / Alien's passport no.	
☐ Dokument tjetër, specifiko llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.	

Vendi i lëshimit Country of issue	Autoriteti i lëshimit Authority of issue	Data e lëshimit Date of issue	Data e skadimit Date of expiry

1.2 Të dhëna personale / Personal data

Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënës/ Mother's name		Emri i babait/ Father's name	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	

Gjinia /Gender: ☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Female ☐ E panjohur / Unknown

[1]Vendimi nr. 329 datë 29.5.2024 publikuar në F.Z nr. 106, datë 27.6.2024, në shkronjën a) të pikës 4 të tij shprehet:
"4. *Në aneksin nr. 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:*
a) Në seksionin A, pika 1, nënpika 1.4, bëhen këto ndryshime: i. Titulli "Banesa" zëvendësohet me "Vetëdeklarim për akomodim"; ii. Fjalia "Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin" zëvendësohet me "Unë vetëdeklaroj që kam akompikën 4 odim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare."

Shtetësia (të) / Current citizenship(s)		ID Ballkani i Hapur / Open Ballkan

Keni nevojë për të aplikuar për vizë?* : ☐ PO ☐ JO

https://punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/2-REGJIMI-I-VIZAVE-PER-TE-HUAJT-26.11.2021.pdf

Nëse Po, plotësoni edhe të dhënat më poshtë:

tipi i vizës
viza
numri i hyrjeve të kërkuara
viza të tjera
data e nisjes
data e mbërritjes
kufiri i hyrjes së parë
mjeti i transportit

*Kjo fushë bëhet e aplikueshme pas datës 1 shtator 2022.

Gjendja Civile / Civil status

☐ Martuar / Married ☐ Beqar / Single ☐ Divorcuar / Divorced ☐ I(e) Ve / Widow(er) ☐ Partner Civil / Civil Partner

☐ Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care ☐ Nuk kam fëmijë në kujdestari / No children in my care

☐ Nr. i fëmijë të mitur në kujdestari

Ju lutemi deklaroni numrin e fëmijëve në kujdestari pavarësisht nëse ju po aplikoni për leje qëndrimi Shqiptare për ta ose jo. Nëse do të aplikoni për leje qëndrimi për një apo disa fëmijë, duhet të plotësohet një formular aplikimi i veçantë për të/ta.

Please state the number of children in custody regardless of whether you are applying for an Albanian residence permit for them or not. If you are going to apply for a residence permit for one or more children, a special application form must be completed.

Profesioni dhe /ose trajnimi: Occupation and/or training:		Gjuha mëmë: Mother Tongue:	

1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant

Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj.
If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.

Bahkia Municipality		Njësia Administrative Administrative Units	
Fshati/Qyteti City / Town		Rruga Street	
Ndertesa nr. Building No.		Hyrja The Entrance	
Kodi Postar Postal Code		Apartamenti Appartment	
Tel. / Cel. / Fax			
E-mail:			

1.4 Banesa / Residence

Ambienti i banimit: Place of residence: ☐ Ambient kolektiv pensione /hostel Collective accommodation/hotel ☐ Hotel

☐ Apartament me: Apartment with Kontratë Qira mujore Monthly Rent Contract m²

Qira ditore rezervuar nëpërmjet platformave online m²
Daily rental booked through online platforms
Në pronësi m²
Owned
Deklaratë Bashkëjetese në ambientet e një të afërmi m²
Declaration of Cohabitation in the premises of a relative

[1] *Ndryshuar aneksi 8 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.4.2022.*

a) Në seksionin A, të nënpikës 1.4, pas fjalëve "... unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin ..." shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Unë kam bashkëlidhur formularim e vetëdeklarimit për akomodim të përshtatshëm, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri.".

Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/ çdo dokument tjetër që provon akomodimin
I am enclosing with the application the rent contract / proof of property/ any other document proving accommodation

SEKSIONI B / SECTION B

2. Informacion mbi qëndrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania

2.1 Arsyet e qëndrimit/ Grounds for residence

Kur dhe në cilin PKK keni hyrë/do të hyni në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / When and in which BCP did you enter/will you enter to Albania?

Datë/Date: PKK/ BCP: Numri i hyrjeve të mëparshme/ previous entry :

Targa e automjetit[3]: Tipi automjetit: Dokumenti i pronësisë

Cilat janë arsyet e qëndrimit tuaj në Shqipëri? [4]/ What are the grounds for your residence in Albania?

- ☐ **Punëmarrës /** Employed
- ☐ **Punë-Institucion Shtetëror /** State Institution Employed
- ☐ **Punë-Institucion Fetar /** _____
- ☐ **Punë-Institucion Humanitar /** _____
- ☐ **I vetëpunësuar /** Self-employed
- ☐ **Punonjës me kualifikim të lartë (KARTA-BLU –AL) /** Highly Qualified employee (KARTA-BLU –AL)
- ☐ **Investitor /** Investor
- ☐ **Shërbime kontraktuese /** Contracting services
- ☐ **Shërbime Vullnetare/** Voluntary services
- ☐ **I transferuar brenda ndërmarrjes /** Intra-corporate transferee
- ☐ **Formim Profesional/** Vocational training
- ☐ **Punëtor Stinor /** Seasonal employment
- ☐ **Sportist/** Sport
- ☐ **Punëtor Ndërkufitar/** _____
- ☐ **Punonjës lëvizës digjital/** _____
- ☐ **Të specifikohet për të tjera/** Specify for others

2.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay

[3] Për tu plotësuar, nëse gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë keni në përdorim një automjet të regjistruar në një vend jashtë Republikës së Shqipërisë./ To be completed, if during your stay in the Republic of Albania you have in use a vehicle registered in a country outside the Republic of Albania

[4] Për çdo kategori të jepet informacion mbi specifikat e lejes së qëndrimit/For each category information provided on the specifics of the residence permit

Unë aplikoj për Leje Unike me afat / I'am applying for a permit term:	Shëno Afatin:

2.3 Informacion mbi punësimin / Information on employment

Të dhëna mbi vendin e punës / Data on working place:

☐ **Punëdhënës/** Employer ☐ **Ndërmarrje** / Enterprise ☐ **Institucion** / Institution

Emertimi i bisnesit / institucionit, kodi fiskal: Name of business/institution business, identity code:	
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati, shteti): Address (street address, no, city/town, country):	
Tel. :	**E-mail:**

Dokumente pune: / Employment documents:

☐ **Miratim punësimi** ☐ **Deklarim për punësim*** ☐ **Vetëdeklarim për qëllime punësimi për rastet Open Ballkan**

Bazuar në shtetësinë/kategorinë e përzgjedhur nga i huaji, në këtë seksion do të shfaqet vetëm alternativa e kërkuar nga ligji (Nëse nuk nevojitet miratim punësimi të shfaqet vetem vërtetimi i deklarimit).
*** Bazuar në nenin 80, të ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", ju nuk keni detyrimin për tu pajisur me dokumentin "Miratim punësimi", mjafton të klikoni mbi opsionin e shfaqur "Deklarim për punësim" për të deklaruar punësimin tuaj pranë zyrës së punësimit.**

2.4 Të ardhurat dhe sigurimi shëndetësor / Incomes and health insurance

☐ **Unë kam pagese punësimi** I am in paid employment ☐ **Unë kam ndërmarrje private** I have my private enterprise ☐ **Shpenzimet e mia i mbulon institucioni** The Institution covers my living cost

Unë kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme së bashku me aplikimin:
I am enclosing the following clarifications with my application:

☐ **Fotokopje e Kontratës se punësimit** / Copy of Employment Contract

☐ **Vërtetim tatimor për vitin e fundit kalendarik (sigurohet nga nëpunësit e administratës)** / Tax statement for the last calendared year (provided by administration officials)

☐ **Vërtetim regjistrimi në Degën e tatim taksave (sigurohet nga nëpunësit e administratës)** / Registration certificate in Tax branch (provided by administration officials)

☐ **Dëshmi nga institucioni për mbulimin e shpenzimeve për jetesë** / Certificate from the Institution for covering of the living cost

☐ **Dëshmi të arsimimit apo eksperiencës profesionale** / Proof of educational or professional experience

☐ **Dëshmi të sigurimit shëndetësor për vitin e fundit kalendarik**[5] / Health insurance certificate for the last calendared year

☐ **Dëshmi të sigurimit shoqëror për vitin e fundit kalendarik** / Social insurance certificate for the last calendared year

SEKSIONI C / SECTION C

